

Nr. 540 Prot  
Tiranë, më 30/062017



Rruga "17 Nëntori"  
Godina Nr. 20, Mëzez Kodër,  
Kashar  
Tiranë-Shqipëri  
Tel: +355 4 2 253 177  
Fax: +355 4 2 253 178

email: info@top-channel.tv  
www.top-channel.tv

**VENDIM NR. 1**  
**I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**  
**TË AKSIONEREVE TE SHOQERISE "TOP CHANNEL" SHA**

Sot, më datë 30/06/2017, ora 13.00, në selinë e **Shoqërisë "Top Channel" Sha** me adresë Rruga "17 Nëntori", Godina nr. 20, Mëzez Kodër, Kashar, Tiranë, Shqipëri u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë, e përbërë nga aksionerët:

**Znj. Vjollca Hoxha**, shtetase shqiptare, madhore, mbajtese e Pasaportës me nr. SF1997404 dhe ID me nr. G95323231L, zotëruese e 8 % të aksioneve të Shoqërisë.


**Lorela Hoxha**, zotëruese e 8 % të aksioneve të Shoqërisë, shtetase shqiptare, mbajtese e pasaportes me numer BG5020378 dhe ID me nr. J36019045D, madhore me zotësi të plote juridike per te vepruar.

**Sara Hoxha**, zotëruese e 8 % të Aksioneve të Shoqërisë, shtetase shqiptare, mbajtese e pasaportes me numer BJ5996445 dhe ID me nr. J65118047S, madhore me zotësi të plote juridike per te vepruar

**Redia Hoxha**, zotëruese e 8 % të Aksioneve të Shoqërisë, shtetase shqiptare, mbajtese e pasaportes me numer BI0520837 dhe ID me nr. J85215052V, madhore me zotësi të plote juridike per te vepruar.

**Itan Hoxha**, zotërues i 8 % të aksioneve të Shoqërisë, shtetas shqiptar, i biri i Dritan dhe i Vjollca, lindur më 04.07.2007 në Itali dhe banues në Tiranë, minoren nën përgjegjësinë e vetme prindërore të nënës se tij Znj. Vjollca Hoxha, mbajtes i pasaportes me numer BG7268879 dhe nga ID me nr. K70704050B, i cili në përputhje me nenin 232 dhe 233 te Ligjit nr 9062 për Kodin e Familjes, përfaqësohet plotësisht nga Znj. Vjollca Hoxha.

Rezulton se janë të pranishëm në mbledhje Vjollca Hoxha, Lorela Hoxha, Sara Hoxha, Redia Hoxha dhe Itan Hoxha, zotërues bashkarisht të 100 % të aksioneve të Shoqërisë "Top Channel" Sha.



Në këtë mbledhje u diskutua lidhur me rendin e ditës si më poshtë:

1. Miratimin e dokumentave perkatëse se bashku me raportin e administrimit dhe raportin e Ekspertit kontabel te autorizuar të shoqërisë audituese BAKER TILLY ALBANIA për pasqyrat financiare të vitit 2016.
2. Miratimi i pasqyrave financiare të shoqërisë “Top Channel” Sha për vitin 2016.
3. Miratimi i raportit të auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2016 për shoqërinë “Top Channel” Sha, i përgatitur nga shoqëria audituese BAKER TILLY ALBANIA.
4. Përcaktimi i destinimit të fitimit të realizuar nga Shoqëria “Top Channel” Sha gjatë vitit 2016.
5. Miratimi i shoqërisë audituese BAKER TILLY ALBANIA për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2017.
6. Të ndryshme sipas propozimeve.

Mbledhja konsiderohet e rregullt pasi në perputhje me nenin 14 të Statutit të Shoqërisë “Top Channel” Sha dhe Ligjit Nr. 9901 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshur, janë të pranishëm personalisht aksionerët që zotërojnë 100 % të aksioneve në kapitalin e Shoqërisë dhe lidhur me çështjen e rendit të ditës;

#### VENDOSËN

1. Miratimin e dokumentave perkatëse se bashku me raportin e administrimit dhe raportin e Ekspertit kontabel te autorizuar të shoqërisë audituese BAKER TILLY ALBANIA për pasqyrat financiare të vitit 2016.
2. Miratimin e Pasqyrave Financiare të Vitit 2016 të Shoqërisë “Top Channel” Sha, sipas të cilit Shoqëria rezulton me fitim neto në shumën prej **1 152 748 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e dymijë e shtatëqind e dyzetë e tetë) Lekë**.
3. Fitimi i realizuar nga shoqëria “Top Channel” Sha, gjatë vitit 2016, të destinohet në këtë mënyrë:
  - 5 % e fitimit e barabartë me **57,637 (pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) Lekë** te kalojë si rezerve ligjore e shoqërisë;
  - Shuma e mbetur e fitimit neto prej **1,095,111 (një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) Lekë** të kalojë në rezerva të tjera/për investime mbasi gjendja financiare e shoqërisë nuk mundëson shpërndarje të dividendëve.



4. Miratimi i shoqërisë BakerTilly Albania sh.p.k (me NIPT K91721010Q dhe numer regjistrimi 166 datë 30/07/2009 në regjistrin publik të ekspertëve kontabël të regjistruar) për auditimin ligjor të pasqyrave financiare të vitit 2017.

**PËR SHOQËRINË "TOP CHANNEL" SHA  
AKSIONERET**

**Vjollca HOXHA**

Vjollca Hoxha

**Lorela HOXHA**

LORELA HOXHA

**Sara HOXHA**

SARA HOXHA

**Redia HOXHA**

Redia Hoxha

**Itan HOXHA**

Vjollca Hoxha



[Handwritten signature]